



Pranimi / Dostizari Prijemni / Pristalo Received / Delivered	08.09.2023	3	viti god year
Organ / Agjencia Organ / Jedinstvo Org. / Unit	SKINSIAK	G029/2023	16
Er Prot Pr. Prot. Prot. No.		Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1067/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.1067/2023 të datës 08.08.2023 të parashtruar nga ankuesja _____ me adresë rruga _____, kundër Vendimit me numër protokolli 22521 të datës 11.07.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Kamenicës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 08.09.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1067/2023 e datës 08.08.2023 e parashtruara nga ankuesja _____
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 22521 i datës 11.07.2023 i Komisionit të Pranimit në Komunën e Kamenicës.

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës më datë 13.04.2023 ka njoftuar për shpalljen e konkursit me Nr.Reference: RN00011443 për pranim për grupin "Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale 2, dy pozita të kërkuara", me afat aplikimi nga data 04.05.2023 deri më datë 11.05.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja e cila është përfshirë në fazën e verifikimit paraprak, fazën e testit me shkrim, vlerësimin e jëtëshkrimit dhe intervistës me gojë, ku pas përfundimit të procedurës sipas njoftimit të vlerësimit përfundimtar të datës 06.07.2023 rezultoi se ankuesja nga i gjithë procesi i vlerësimit ka marrë gjithsej 78.4 pikë duke u renditur e treta nga kandidatët.

Ankuesja kundër vlerësimit përfundimtar më datë 06.07.2023 ka parashtruar ankesë tek Komisioni

i Pranimit. Komisioni i Pranimit më datë 11.07.2023 ka nxjerr Vendim me numër protokolli 22521 përmes të cilit ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankueses duke e lënë në fuqi njoftimin për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve.

Ankuesja kundër Vendimit me numër protokolli 22521 të datës 11.07.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Kamenicës, më datë 08.08.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 5582/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë; Vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe Shkelje e dispozitave materiale.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave, me datën 11.08.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Komuna e Kamenicës. Ndërsa Këshilli më datë 24.08.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave, me rastin shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 5582/2023 të datës 08.08.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 22521 të datës 11.07.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Kamenicës; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 11.08.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 24.08.2023; Konkursin me Nr.Reference: RN00011443 për pranim për grupin *Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale 2*; Vendimin me Nr. 17469 të datës 25.05.2023 për formimin e Komisionit të Pranimit; Listën e aplikantëve; Listën e verifikimit paraprak e datës 15.05.2023; Njoftimin për rezultatet përfundimtare i datës 06.07.2023; Listën e renditjen përfundimtare të kandidatëve; Ankesën e ankuesës e datës 06.07.2023 e parashtruar tek Komisioni i Pranimit; Aplikacionin e kandidatës Diplomën me Nr. 7616, Certifikatën e datës 22.06.2013, Certifikatën e datës 31.10.2013, 30.10.2014, 30.09.2015, Mirënjohjen nga Këshilli i Studentëve i Universitetit të Prishtinës, Certifikatën për periudhën 21-22.04.2021, Certifikatë për periudhën 01.12.2021 deri 30.06.2022, Letër reference e datës 30.04.2021, Reference e darës 07.06.2021, Marrëveshje për praktikant e datës 19.05.2021, Marrëveshje për praktike e lidhur me CARUTAS, Marrëveshje për praktike e datës 01.04.2022, Letër reference e datës 24.11.2022, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 04.05.2023; Aplikacionin e kandidatës , Diplomë me Nr. 213, Certifikatën e datës 02.03.2022, Marrëveshje për punë praktike e datës 05.07.2022, Kontratë për shërbime e datës 01.10.2022, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.05.2023; Aplikacionin e ankueses, Diplomën me Nr. 3430, Diplomën me Nr. 524, Certifikatën e datës 02.03.2023, Certifikatën e datës 29.12.2022, Kontratë e datës 14.05.2011, 20.06.2011, 26.11.2011, 22.10.2011, 30.03.2012, 27.04.2012, 15.09.2012, 18.03.2013, 15.04.2013, Kontratë punës për kohë dhe detyra specifike e datës 20.09.2012, Kontratë punë për punë dhe detyra specifike e datës 13.08.2013, 07.03.2014, 28.03.2014, Vërtetimin e datës 16.05.2022, Vendimin për kompensimin e anëtarëve të komitetit për shëndetësi, çështje sociale dhe emergjenca e datës 10.02.2015, Marrëveshje për praktikant e datës 21.11.2018, Kontratë pune e datës 01.05.2019, Rekomandim i datë 16.05.2022, Shkresë nga IDRA e datës 22.05.2019, Dokument identifikimi, Certifikatën mbi dënimet penale e datës 08.05.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e bashkangjitura të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka analizuar dispozitat e ligjit material, konstatoi se ankesa e ankueses, është e **pabazuar, sepse:**

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 22521 të datës 11.07.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Kamenicës, pretendon se: Në këtë procedurë ka pasur shkelje procedurale dhe materiale ngase duke mos u përzgjedhur kandidatët që kanë kualifikime me të larta dhe më profesionale; Në testin me shkrim ka pasur shkelje pasi që pyetjet e dërguara nga komuna tek ministria i janë dhënë paraprakisht kandidatëve që janë të radhitur të parët dhe testi me shkrim ka pasur gabime profesionale dhe drejtshkrimore; Vlerësimi i jetëshkrimit është bërë në kundërshtim me kriteret dhe jo real pasi që nuk mund të vlerësohet me shumë një Juriste se një Sociologe; Vlerësim i intervistës me gojë është bërë në mënyrë jo të ligjshme; Po ashtu nuk janë publikuar pikën e secilës fazë; Kështu që ky konkursi ka qenë jo transparent; Vendimi i kundërshtuar me ankesë është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi për shkak se ka dhënë konstatime boshe.

Sipas konkursit me Nr.Reference: RN00011443 për pranim për grupin "*Specialist të Përgjithshëm të Shërbimeve Sociale për pozitën Zyrtar për Shërbime Sociale 2*", dy pozita të kërkuara, kërkesat të përgjithshme formale janë paraparë: "*Arsinimi i kërkuar: Diplomë/a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studime në këto drejtime: Psikologji, Sociologji, Punë Sociale, Juridik, Pedagogji ose në ndonjë lëmi tjetër të lidhur ngushtë me shërbimet sociale dhe familjare, Përvoja e punës e kërkuar: Së paku një (1) vite përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.*

Lidhur me pretendimin ankimore të ankueses, se në këtë procedurë ka pasur shkelje procedurale dhe materiale ngase duke mos u përzgjedhur kandidatët që kanë kualifikime me të larta dhe më profesionale, Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë kriteret e konkursit konstaton se kandidatet e renditura me më së shumti pikë, rezultojnë se nga aplikacioni i tyre kandidatja për nga përgatitja profesionale posedon Diplomën me Nr. 7616 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës përmes të cilës dëshmohet se më datë 22.09.2021 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Filozofik duke marr titullin *Bachelor i Punës Sociale*, ndërlidhur me dëshmitë e përvojës së punës e njëjta posedon Referencën e datës 07.06.2021 të lëshuar nga Qendra për Punë Sociale në Kamenicë me të cilën dëshmohet se nga data 01.03.2021 deri më datë 28.05.2021 ka kryer praktikën në këtë qendër, sipas Marrëveshjes për praktikant të datës 19.05.2021 dëshmohet se nga data 22.05.2021 deri më datë 20.09.2021 ka kryer praktikën në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale-QPS, sipas Marrëveshjes së lidhur me Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës të datës 01.04.2022 rezultojnë se ka qenë e angazhuar si praktikante me pagesë prej datës 04.04.2023 deri më datë 03.10.2022. Sipas aplikacionit të kandidatës , rezultojnë se e njëjta për nga përgatitja profesionale posedon Diplomim me Nr. 213 të lëshuar nga Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka" me të cilën dëshmohet se më datë 01.07.2020 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin Juridike duke marr titullin *Bachelor në Juridik, LLB*, ndërlidhur me përvojën e punës e njëjta sipas Certifikatës së datës 01.03.2022 të lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjilan dëshmohet se ka përfunduar praktikën prej datës 01.03.2021 deri më datë 01.03.2022, sipas Marrëveshjes së lidhur me Agjencinë e Punësimit të Republikës së datës 05.07.2022 rezultojnë se nga data 05.07.2022 deri më datë 04.01.2023 ka përfunduar praktikën me pagesë. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit, nga dosjet e këtyre kandidatëve vlerëson se të njëjti kanë plotësuar kushtet e konkursit për nga përgatitja profesionale e kërkuar dhe për nga përvoja e punës, si rezultat i kësaj pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Sa i përket pretendimit ankimore të ankueses se në testin me shkrim ka pasur shkelje pasi që pyetjet e dërguara nga komuna tek ministria i janë dhënë paraprakisht kandidatëve që janë të radhitur të parët dhe testi me shkrim ka pasur gabime profesionale dhe drejtshkrimore, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja nuk ka mund të argumentoj një pretendim të tillë me prova, rrjedhimisht edhe pretendimi i saj është i pa provueshëm.

Lidhur me pretendimin e ankueses se vlerësimi i jetëshkrimit është bërë në kundërshtim me kriteret dhe është jo real pasi që nuk mund të vlerësohet me shumë një Juriste se një Sociologe, Kolegji i Këshillit, konstaton se duke marr parasysh që ankuesja në testin me shkrim ka marr gjithsej 55 pikë atëherë ka plotësuar kushtin ligjor për të kaluar në fazën e vlerësimit të jetëshkrimit po ashtu edhe kandidatet fituese me më së shumti pikë kanë plotësuar kushtin e paraparë me nenin 22 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"2. Vetëm kandidatët që kanë marrë të paktën dyzet (40) pikë në testimin me shkrim, i nënshtrohen vlerësimit të jetëshkrimit"*, andaj duke marr parasysh këtë edhe është bërë vlerësimi i jetëshkrimit i cili është bërë në bazë të kërkesave të konkursit dhe i cili konsiston në vlerësimin e cilësisë dhe nivelit të arsimimit, të përvojës domethënëse në punë dhe të trajnimeve që lidhen me vendin e punës në lëmin përkatës të lidhur me grupin për të cilët zhvillohet konkurimi, të përcaktuar me paragrafin 3 të nenit 22 të Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Duke marr parasysh kriteret e vlerësimit të jetëshkrimit të përcaktuar me nenin 22 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesja nga vlerësimi i jetëshkrimit ka marr gjithsej 15.8 pikë nga 20 sa është maksimumi, kandidatja që ka numrin më të madh të pikëve është vlerësuar me gjithsej 17.8, kurse kandidatja tjetër është vlerësuar me gjithsej 13.6, si rrjedhojë duke pasur parasysh që pikët e vlerësimit të jetëshkrimit janë mesatarja e vlerësimit të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Pranimit, atëherë sipas kësaj pikëpamje vlerësimi i jetëshkrimit është bërë në pajtim me nenin 22 paragrafi 5 të Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, i cili përcakton se: *"secili nga anëtarët e Komisionit të Pranimit, bën vlerësimin e detajuar për secilën prej faktorëve të përcaktuara në pajtim me paragrafin 3 dhe 4 të këtij neni. Vlerësimi përfundimtar i jetëshkrimit për një kandidat është mesatarja aritmetike e vlerësimeve e të gjithë anëtarëve"*, mbi bazë të kësaj Kolegji vlerëson se në këtë çështje nuk ka pasur diskriminim ndaj ankueses në raport me kandidatët tjerë, kështu që pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pretendimin e ankueses se vlerësimi i intervistës me gojë është bërë në mënyrë jo të ligjshme, konstaton se ky pretendim është i pabazuar ngase ankuesja nuk mund të argumentoj me provë se ndonjë nga kandidatët e tjerë është favorizuar në këtë fazë për shkak se dallimi mes dy kandidateve të para dhe ankuese sa i përket pikëve të intervistës me gojë është shumë i vogël, respektivisht kandidatja e parë në intervistë me gojë është vlerësuar me 8.8 pikë, kandidatja e dytë është vlerësuar me 7.8, ndërsa ankuesja është vlerësuar me 7.6 pikë, kështu që sipas Kolegjit edhe në këtë fazë nuk është evidentuar ndonjë shkelje pasi që janë respektuar dispozitat e nenit 23 të Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrjedhojë pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Nga pretendimi i ankueses se ashtu nuk janë publikuar pikën e secilës fazë, Kolegji i Këshillit, konstaton se kandidatët për pikët e vlerësimit të të gjitha fazave të procedurës njoftohen përmes sistemit elektronik dhe për këtë ankuesja është njoftuar për shkak që e njëjta edhe në ankesë i referohet pikëve të fazave ashtu siç janë të publikuara, po ashtu kandidatët në procedurë janë njoftuar edhe me vlerësimin përfundimtar e që rezulton se janë edhe pikën e të gjitha fazave të procedurës, e në këtë rast kandidatët janë njoftuar sipas nenit 9 të Rregullores (QRK) 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, kështu që pretendimi i ankueses është i pabazuar.

Marr për bazë konstatimet si më lartë si dhe lidhur me vlerësimin përfundimtar për këtë pozitë, Kolegji i Këshillit, konstaton se nga ky proces kanë rezultuar si kandidatë fitues katër (4) kandidatët në mesin e tyre edhe ankuesja ngase kanë marr më shumë se 70 pikë, por meqë në këtë konkurs janë kërkuar dy kandidatët atëherë ankuesja nga pikët e grumbulluar nuk ka rezultuar të jetë e renduar e para apo e dyta sepse kandidatja e parë nga numri i përgjithshëm ka marr 88.6 pikë, kandidatja e dytë nga numri i përgjithshëm ka marr 83.4, ndërsa ankuesja ka marr 78.4, andaj duke ju referuar Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht me nenin 25 paragrafi 2 ndërlidhur me nenin 26 paragrafi 1 të kësaj rregullore përcaktohet se: *"25.2. Kandidatët që janë vlerësuar me shtatëdhjetë (70) pikë e më shumë, janë kandidatë fitues. Njësia Përgjegjëse publikon listën e kandidatëve fitues në pajtim me nenin 9 të kësaj Rregulloreje; 26.1 Kandidati fitues, sipas renditjes, duke filluar nga ai me më shumë pikë, njoftohet nga njësia përgjegjëse për pozitën e lira dhe ka të drejtën të përzgjedhë çdo pozitë të lirë të Grupit dhe të emërohet në të, për të cilin është zhvilluar procedura e pranimit, si dhe në çdo pozitë tjetër të lirë të të njëjtit Grup, që krijohet e lirë deri në një (1) vit nga shpallja publike e listës të kandidatëve fitues"*, Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja në këtë procedurë të pranimit nuk ka mund të emërohet për shkak që është renditur me pikë si e treta, ndërsa sipas Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përparësi ka kandidati i cili ka numrin më të madh të pikëve siç parashihet me nenin 26 paragrafi 1 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit konstaton se Njoftimi për rezultatet përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve i datës 06.07.2023 është nxjerr në pajtim dispozitat Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Sa i përket pretendimeve ndaj Vendimit me numër protokolli 22521 të datës 11.07.2023 të Komisionit të Pranimit në Komunën e Kamenicës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ky vendim është nxjerr me konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe juridike, ngase sipas këtij vendimi janë shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të ankueses në pajtim me nenin 48 ndërlidhur me nenin 134 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa ky vendim është nxjerr edhe në pajtim me nenin 25. Paragrafi 6 të Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si rrjedhojë pretendimi i ankueses ndaj këtij vendimi është i pabazuar.

Nga shqyrtimi i procedurës, Kolegji i Këshillit, konstaton se në këtë procedurë pranimi nuk janë evidentuar shkelje procedurale dhe materiale si rrjedhojë procedura është zhvilluar në pajtim me parimet e nenit 6 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik të ndërlidhura me nenin 34 të këtij ligji, dhe në pajtim me dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës që kanë të bëjë me pranimin në pozita

të shërbimit civil, kështu që pretendimi i ankueses se ky konkurs ka qenë jo transparent është pretendim i pabazuar.

Andaj bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.1067/2023, datë 08/09/2023

Avdyll BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Kamenicës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.